

---

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I  
SHOQËRISË ME  
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”**

---

# **AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

## **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”**

(Hartuar në bazë të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”)

### **KREU I EMRI I SHOQËRISË, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

Sot, në Tiranë më datë 20.04.2022:

Unë **KLITON NENAJ**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 03.05.1978, mbajtësi i kartës së identitetit nr.034349636 dhe numër personal H80503049H themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** (më poshtë e quajtur **“Shoqëria”**).

#### **Neni 1 FORMA E SHOQËRISË**

- 1.1. Ortaku themelon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në kuptimin që përgjegjësia e tij është e kufizuar deri në shumën e kapitalit të derdhur, pa iu njohur asnjë përgjegjësi tjetër.
- 1.2. Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër në përputhje me Legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

#### **Neni 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË**

- 2.1. Emërtimi i shoqërisë është **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”**.
- 2.2. Emërtimi dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

#### **Neni 3 BAZA JURIDIKE**

- 3.1. Shoqëria **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** e fiton personalitetin e saj juridik nga dita e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 3.2. Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e Statutit dhe Aktit të Themelimit.

#### **Neni 4 OBJEKTI I SHOQËRISË**

- 4.1. Shoqëria **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** ushtron veprimtarinë e saj me qëllim realizimin e fitimit, duke u mbështetur në parimet e likuiditetit, sigurisë dhe rentabilitetit, sipas rregullave të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.

- 4.2. Shoqëria ka si objekt të aktivitetit të saj:
- a) Studim, projektim, mbikëqyrje, kolaudim, konsulencë dhe menaxhim në ndërtime civile dhe ekonomike, në ndërtimet rrugore, në ndërtimet hekurudhore, në vepra arti, në ndërtime detare, në ndërtime hidraulike e hidroteknike, në vepra të veçanta e punime speciale, në punime restaurimi, në punime karpenterie, në punime të impianteve teknologjike, në punime montimi, në impiantet e prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë, në punime shërbimi, në punime topogjeodezike, në trajtimin e mjedisit të ujërave dhe të mbeturinave të v.n.m. veprimi i ndikimeve në mjedis.
  - b) Importim dhe rishitje brenda dhe jashtë vendit e sistemeve, pajisjeve dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit duke kryer përmirësime, modifikime, integrimi dhe shërbime gjithëpërfshirëse të implementimit si administrimi i projekteve, analizë, skicim, trajnime dhe mbështetje funksionale dhe teknike.
  - c) Programim dhe zhvillim i sistemeve dhe aplikacioneve informatike për funksionim në Cloud ose lokalisht, ofrim sistemi apo programi si shërbim, asistence teknike dhe operacionale për administrimin e sistemeve dhe teknologjive të informacionit.
  - d) Kurse kualifikimi dhe trajnimi, konsulencë në sektorin e ndërtimit, teknologjisë së informacionit dhe operacione të ndryshme komisionere.
  - e) Pjesëmarrje në tendera publike dhe private për aktivitete të lidhura me objektin e shoqërisë të përcaktuar në paragrafët a, b dhe c të këtij neni.
- 4.3. Shoqëria mund të kryejë çdo lloj veprimtarie tjetër që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe që siguron fitime dhe të ardhura të ligjshme brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, mund të kryejë çdo operacion prodhimi, tregtar dhe financiar, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj. Kjo përfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqërive të tjera brenda dhe jashtë vendit.
- 4.4. Shoqëria, me vendim të Administratorit mund të lidhë marrëveshje tregtare apo bashkëpunimi me shoqëri apo sipërmarrje të tjera, si dhe të kryejë çdo veprim tregtar që konsiderohet i nevojshëm me qëllim arritjen e objektit të veprimtarisë së saj.
- 4.5. Për të realizuar qëllimet e saj Shoqëria mund të sigurojë dhe përdorë financime nga ortakët, nga vende të tjera ose nga institucione financiare vendase ose të huaja.
- 4.6. Shoqëria mund të ndryshojë objektin e veprimtarisë së saj dhe emërtimin me vendim të Asamblesë së ortakëve, në përputhje me legjislacionin dhe regjistrohet në QKB dhe në Organet Tatimore.
- 4.7. Shoqëria **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** do të ushtrojë veprimtarinë për ato aktivitete që kërkojnë marrjen e licencave dhe lejeve përkatëse vetëm pas marrjes së tyre nga organet dhe strukturat e caktuara nga ligji.
- 4.8. Shoqëria **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** do të ushtrojë veprimtarinë në përmbushje të objektit të veprimtarisë së saj, duke zbatuar të gjithë ligjet dhe aktet nënligjore rregulluese në lidhje me licencimin, kushtet, procedurat dhe afatet e kërkuara.
- 4.9. Gjatë kohëzgjatjes së aktivitetit të saj Shoqëria **“INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K”** do të zbatojë standardet më të larta të etikës profesionale dhe zbatimit të ligjshmërisë.

- 5.1. Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: “Rr. Bardhyl, Pall.18, Shk. 1, Ap.13, Tiranë”. Ortakët mund të vendosin mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjetër. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin dege dhe/ose zyra përfaqësimi apo agjenci të saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj.

## **Neni 6 KOHËZGJATJA**

- 6.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore me afat të pacaktuar.

## **KREU II KAPITALI I SHOQËRISË DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **Neni 7 KAPITALI I SHOQËRISË**

- 7.1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100 (njëqind) lekë, i ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100 (njëqind) lekë.  
Z. Kliton NENAJ zotëron 1(një) kuotë të kapitalit themeltar, pra 100% të tij në vlerën 100 (njëqind) lekë. Kapitali themeltar është investuar nga ortaku i vetëm themelues në total. Derdhja e kapitalit do të kryhet pas regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar, gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.
- 7.2. Çdo pjesë e kapitalit themeltar i jep të drejtën e një vote zotëruesit të saj.
- 7.3. Ortaku i Shoqërisë “**INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K**” përgjigjet për detyrimet ndaj të tretëve deri në vlerën e kontributit të tyre në formimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë.

### **Neni 8 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETËT**

- 8.1. Transferimi i kuotave të kapitalit të Shoqërisë mund të bëhet me shitje, dhurim, trashëgimi, ose me çdo mënyrë tjetër të parashikuar nga legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 8.2. Në rast transferimi të kuotave tek persona të tretë jashtë Shoqërisë, qoftë me shitje qoftë me dhurim, ortaku që synon të transferojë kuotat duhet t’i komunikojë ortakëve të tjerë vullnetin e tij me shkrim. Ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes të kuotave të ortakëve, me kushte të barabarta, dhe duhet ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda 30 ditëve nga marrja e komunikimit të vullnetit të ortakut për të transferuar kuotat. Mosrespektimi i kësaj dispozite e bën të pavlefshëm transferimin e kuotave.
- 8.3. Vlera e kuotës që transferohet do të përcaktohet nga një ekspert i emëruar nga ortakët me marrëveshje ose nga gjykata në rast se ortakët nuk bien dakord.

### **NENI 9 ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 9.1. Kapitali themeltar mund të zmadhohet me vendim të ortakut, në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në bazë të raportit të Administratorit të Shoqërisë.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet me anë të kontributeve të reja në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit si pjesë të Kapitalit Themeltar.
- 9.3. Në rast zmadhimi të kapitalit me anë të kontributeve në para, të gjitha pjesët e reja të Kapitalit duhet të nënshkruhen dhe të shlyhen tërësisht nga Ortaku. Ato duhet të depozitohen nga nënshkruesit në Bankë për llogari të Shoqërisë “**INTEGRATED DEVELOPMENT ENGINEERING SH.P.K**”.

#### **NENI 10 ZVOGËLIMI**

- 10.1. Zvogëlimi i kapitalit mund të kryhet me vendim të ortakut, në përputhje me ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- 10.2. Zvogëlimi i prek Ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që ata zotërojnë.

### **KREU III ORTAKËT E SHOQËRISË DHE FINANCIMET**

#### **Neni 11 ORTAKËT**

- 11.1. Ortak i vetëm i shoqërisë është Z. Kliton Nenaj, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë, më 03.05.1978, mbajtës i kartës së identitetit nr. 034349636 dhe numër personal H80503049H.

#### **Neni 12 ORGANET E SHOQËRISË**

- 12.1. Organet drejtuese të Shoqërisë janë:
  - a) Asambleja e përgjithshme – organi më i lartë vendimmarrës;
  - b) Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i Shoqërisë;

#### **Neni 13 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

- 13.1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht.
- 13.2. Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme, e thirrur dhe e mbledhur rregullisht, në përputhje me ligjin dhe me këtë Statut janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.
- 13.3. Asambleja e Përgjithshme mbledhet në rastet e parashikuara nga ky Statut, nga ligji për shoqëritë tregtare, ligje të tjera, dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë.

- 13.4. Asambleja e Përgjithshme mbahet në selinë e Shoqërisë ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve Jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
- 13.5. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratorët. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme mund të kërkohet edhe nga ortaku ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme.
- 13.6. Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të zakonshme e jashtëzakonshme.

#### **Neni 14**

#### **ASAMBLEJA E ZAKONSHME**

- 14.1. Asambleja e zakonshme mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administratorëve, inventarëve dhe llogarive vjetore.
- 14.2. Vendimet merren me shumicë të zakonshme të votave në prani të ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 50 % të kuotave.
- 14.3. Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 14.2, Asambleja do të mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Në rast se as në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

#### **Neni 15**

#### **ASAMBLEJA E JASHTËZAKONSHME**

- 15.1. Asambleja e Përgjithshme thirret në sesione të jashtëzakonshme sa herë është e nevojshme për marrjen e vendimeve në interes të Shoqërisë.
- 15.2. Vendimet që kanë të bëjnë me (por pa u kufizuar vetëm në to): ndryshimin e neneve të Statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, ndryshimin thelbësor të objektit të veprimtarisë së Shoqërisë, prishjen e Shoqërisë konsiderohen vendime të jashtëzakonshme.
- 15.3. Vendimet e jashtëzakonshme merren nga Asambleja e Përgjithshme me  $\frac{3}{4}$  e votave në prani të ortakëve që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.
- 15.4. Nëse nuk arrihet kuorumi sipas pikës 15.3, Asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëjtin rend dite. Në rast se në mbledhjen e dytë nuk arrihet kuorumi, ortakët e pranishëm ose rregullisht të përfaqësuar do të përbëjnë kuorumin.

#### **Neni 16**

#### **PJESËMARRJA, VOTIMI DHE PËRFAQËSIMI**

- 16.1. Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuar nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.
- 16.2. Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblesë nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Neni 17**  
**KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME**

17.1. Asambleja e Përgjithshme vendos për:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshimin e Statutit;
- c) emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre;
- d) emërimin dhe shkarkimin e likuidatorit levë dhe eksperteve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratoret, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë;
- g) miratimin e zmadhimit dhe zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratorit/ëve;
- j) shpërndarjen e fitimeve;
- k) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- l) miratimin e rregullave proceduralë të mbledhjeve të Asamblesë;
- m) çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga ky Statut.
- n) kërkesa për kredi bankare dhe / ose nënshkrimin të faturave, garanci ose garanci në favor të palëve të treta

**Neni 18**  
**FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 18.1. Organi i Administrimit të Shoqërisë në përputhje me dispozitat në fuqi përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e Shoqërisë fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 18.2. Financimet e mëtejshme të ortakëve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU IV**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË DHE SHPËRBLIMET**

**Neni 19**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

19.1. Shoqëria administrohet nga një Administrator

**Kliton Ismail Nenaj**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë, më 03.05.1978, rezident në Tiranë dhe mbajtës i kartës së identitetit nr. H80503049H, i cili emërohet nga ortakët e shoqërisë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje.

- 19.2. Administratori shkarkohet nga detyra, në çdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblesë së Përgjithshme sipas Statutit të Shoqërisë. Administratori ka kompetencat dhe detyrat e mëposhtme:
- a) mbikëqyr dhe zbaton politikën e biznesit të Shoqërisë;
  - b) përfaqëson Shoqërinë;
  - c) kujdeset që Shoqëria të zbatojë ligjet dhe standardet e mbajtjes së llogarive;
  - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve ja paraqet asamblesë së Përgjithshme për miratim;
  - e) siguron që deklaratat e llogarive vjetore si dhe raporti i ecurisë së biznesit dhe çdo deklaram tjetër i detyrueshëm sipas ligjit ose statutit, janë bërë siç duhet;
  - f) siguron që auditimi i librave dhe i të dhënave kryhet të paktën një herë në vit nga ekspertë kontabël të certifikuar dhe raporti i llogaritarëve publikë të certifikuar t'i vihet në dispozicion Asamblesë së Përgjithshme;
  - g) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- 19.3. Administratori mund të ndërmarrë apo të kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme për arritjen e objektit të Shoqërisë përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakëve apo organeve të tjera të Shoqërisë.
- 19.4. Përveç sa më sipër, Administratori ka gjithashtu:
- a) të gjitha të drejtat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm, të gjitha kompetencat dhe të drejtat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua njeh shprehimisht ortakëve.
  - b) Administratori, bazuar në një vendim të asamblesë së ortakëve, mund të emërojë drejtorë, përfaqësues me prokurë dhe të mandatuar të përgjithshëm për veprime të caktuara ose kategori veprimesh.
  - c) Administratori i shoqërisë nuk mund të shesë dhe/ose blejë pasuri të paluajtshme në emër dhe për llogari të shoqërisë, pa marrë më parë miratimin paraprak me shkrim të asamblesë së ortakëve.

## **Neni 20 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 20.1. Paga dhe shpërblimet e administratorit përcaktohen me vendim të zakonshëm të asamblesë së përgjithshme ose ortakut të vetëm. Shpërblimet bazë të administratorit mund ti bëhen shtesa të cilat mund të jenë përqindje fitimi ose të ngjashme. Kriteret e shpërblimit, shpërblimi individual dhe efekti vjetor i shpërblimit të administratorit në strukturën e kostove të shoqërisë tregtare publikohen së bashku me pasqyrat financiare vjetore.

## **KREU V KONTROLI KONTABËL I SHOQËRISË VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

### **Neni 21 KONTROLI KONTABËL**



21.1. Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspert Kontabël të Autorizuar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Ortakët do të emërojnë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.

## **Neni 22 VITI FINANCIAR**

22.1. Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti. Si përjashtim, viti i parë financiar i veprimtarisë së Shoqërisë fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## **Neni 23 BILANCI DHE REZERVAT**

23.1. Me mbylljen e secilit vit financiar Administratorët marrin masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur në mënyrë që ortakët të vendosin mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.

23.2. Ortakët vendosin mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma janë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.

23.3. Ortakët në çdo moment mund të vendosin krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

## **Neni 24 FITIMI**

24.1. Fitimi ose kur është rasti humbja e ushtrimit financiar përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të ushtrimit, në pajtim me rregullat e parashikuara në legjislacionin mbi kontabilitetin.

24.2. Fitimi i ushtrimit mund të destinohet për të krijuar e plotësuar rezervat e shoqërisë ose për t'ju shpërndarë ortakëve.

24.3. Në rastin e një humbje Asambleja që miraton llogaritë duhet të vendosë për mbulimin e humbjes.

## **Neni 25 SHPËRNDARJA E FITIMIT**

25.1. Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i ushtrimit përkatës të cilit:

- a) i zbriten humbjet e mbartura dhe shumat që hiqen për rezervat
- b) i shtohen fitimet e mbartura.

25.2. Fitimet ndahen ndërmjet ortakëve në përputhje me përqindjen e kapitalit themeltar që ka secili ortak.

## **Neni 26 DIVIDENTËT**

26.1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë shpërndarjen e dividendëve vetëm pasi:

- a) nga njëra anë të ketë miratuar llogaritë vjetore;
- b) nga ana tjetër të ketë përcaktuar shumën që do të shpërndahet.

#### **Neni 27**

### **PARADHËNIET PËR DIVIDENTËT**

27.1. Paradhënie për dividendë janë shumat që u jepen ortakëve përpara miratimit të llogarive vjetore dhe caktimit nga asambleja të dividendit përfundimtar. Këto paradhënie janë të ligjshme, por duke respektuar kërkesat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe konkretisht me kusht që:

- a) shoqëria veç rezervës së domosdoshme e ketë në dispozicion rezerva me një shumë të paktën të njëjtë me paradhëniet e shpërndara, ose që një raport vërtetimi i bërë nga një ekspert kontabël i autorizuar të bëjë fitime neto më të mëdha se shumata e paradhënies.
- b) shpërndarja e paradhënies duhet të vendoset nga administratori i cili duhet të caktojë edhe datën e kthimit.

#### **Neni 28**

### **VENDIMI PËR HUMBJET**

28.1. Në rastin kur rezultati i ushtrimit të mbyllur është humbje, asambleja e përgjithshme mund të vendosë:

- a) ose mbartjen e kësaj humbjeje në ushtrimin e ardhshëm, duke kaluar në një llogari të veçantë “humbje të mbartura”
- b) ose pastrimin e saj nga rezervat, duke përfshirë edhe rezervën e domosdoshme.

28.2. Vetëm kur humbjet e mbartura të jenë pastruar tërësisht mund të rifillojë shpërndarja e fitimeve.

#### **Neni 29**

### **DETYRIMI PËR TË PËRBALLUAR HUMBJET**

29.1. Detyrimi për të përballuar humbjet është përpjesëtimor me kontributet e secilit ortak.

29.2. Çdo marrëveshje që parashikon përjashtimin e një ortaku nga përballimi i humbjeve është i pavlefshëm.

29.3. Nëse shoqëria prishet dhe vihet në likuidim, atëherë likuidatori është i detyruar të shlyejë të parët kreditorët e saj.

#### **KREU VI**

### **PRISHJA DHE NJOFTIMET**

#### **Neni 30**

### **PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

30.1. Në rastin e likuidimit të Shoqërisë do të zbatohen dispozitat e parashikuara në ligjin nr.9901 datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (të ndryshuar).

30.2. Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut të vetëm ose asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) me vendim të gjykatës;

### **Neni 31 NJOFTIMET**

- 31.1. Të gjitha njoftimet kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorëve të Shoqërisë. Për këtë qëllim, brenda 5 (pesë) ditëve nga regjistrimi efektiv i çdo ortaku (si i tillë) në regjistrin tregtar, ky i fundit është i detyruar ti komunikojë administratorit adresën postare dhe adresën postare elektronike ku dëshiron të marrë njoftimet. Brenda të njëjtit afat i komunikon administratorit të shoqërisë adresën e re, kur adresa ndryshon, në të kundërt njoftimi konsiderohet si i kryer rregullisht.
- 31.2. Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 31.3. Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

### **KREU VII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 32 LIGJI I ZBATUESHËM**

- 32.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë Akt themelimi dhe Statutin e shoqërisë, si dhe me ligjin shqiptar. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë veprimtarisë së shoqërisë, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre janë Gjykatat Shqiptare.
- 32.2. Ky Akt hartohet në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, dhe pasi lexohet nga Ortakët themelues, firmoset si më poshtë prej tyre.

#### **ORTAK I VETËM I SHOQËRISË**

**KLITON NENAJ**

